

Sanja Sovrlliq ▪ Snezhana Gjapiq



TERR DHE HESHTJE PAS MARRËVESHJES SË BRUKSELIT

Analizë e marrëveshjes për energji dhe telekomunikime

Ne këtu,
siç duket
nga zhvillimi i
deritanishëm i ngjarjeve,
kemi njerëz që marrin
vendime shumë të
rëndësishme e që nuk
kanë ide se kush është
ulur përballë tyre



Sanja Sovrlliq, Snezhana Gjapiq
TERR DHE HESHTJE PAS MARRËVESHJES SË BRUKSELIT

Botues

OJQ „Radio MIR“
Vojske Jugosllavije 26
Leposaviq

Për botuesin

Sanja Sovrlliq

Shtyp

Urban Pixel
Mitrovica e Kosovës

Tirazhi

200 kopje

PËRMBAJTJA

	LISTA E SHKURTESAVE	5
1	HYRJE	7
2	TELEKOMUNIKIMET	9
	REZULTATET	13
	SINJAI TELEVIZIV	14
	TELEFONIA FIKSE DHE MOBILE	15
	REZULTATET	17
	PROBLEME ME FUNKSIONIMIN E TELEFONISË NË VERI TË KOSOVËS	19
	GRUPI PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES	20
	REZULTATET	20
3	ENERGJIA	21
	GJENDJA NË FUSHËN E ENERGJISË NË VERI TË KOSOVËS	23
	RRJEDHA E NEGOCIATAVE PËR ENERGJINË	26
	THEMELIMI I KOMPANIVE TË REJA	27
4	PËRFUNDIM	31
	TELEKOMUNIKIMET	32
	ENERGJIA	33
5	REKOMANDIME	35
	REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	36
	TELEKOMUNIKIMET	36
	ENERGJIA	36
	REKOMANDIME PËR QYTETARËT	37
	LITERATURA	38

LISTA E SHKURTESAVE

EMS – Elektro-rrejti i Serbisë

ENTSO E – Rrjeti evropian in operatorëve për transmetimin e energjisë elektrike

KOSTT – Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike i Kosovës

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.

KEDS – Shërbimi i shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovës SH.A.

EPS – Elektroekonomia e Serbisë

EK – Elektrokosmet (Elektrodistribucija Kosovska Mitrovica)

ES – Elektroserver

ITU – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit

ARKEP – Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës

NP – Ndërmarrje Publike

AKS – Asociacioni i Komunave Serbe

ARBK – Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve e Kosovës

ICANN – Organizata Ndërkombëtare për rregullimin alternativ të sektorit të komunikimeve

GSM – Sistemi Global për Komunikim Mobil

HYRJE



Në katër komunat në veri të Kosovës, furnizimi me energji elektrike nuk është i qëndrueshëm (mungesë e shpeshtë e energjisë, veçanërisht gjatë periudhës së dimrit) dhe cilësia e këtyre shërbimeve nuk është në nivel të kënaqshëm. Që nga viti 1999, në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit nuk funksionon pagesa e energjisë elektrike, as shpërndarësit e autorizuar nuk kanë mekanizma për të arkëtuar mjetet për shërbimet e dhëna. Në kuadër të Dialogut të Brukselit janë nënshkruar disa marrëveshje që rregullojnë fusha specifike, por zbatimi i tyre është shënuar nga probleme të shumta, vonesa dhe të panjohura. Marrëveshjet për energjinë dhe telekomunikimet lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës së qytetarëve dhe, ndryshe nga marrëveshjet e tjera, prekin një numër të madh qytetarësh

Marrëveshja për Telekomunikacion kishte për qëllim marrjen e një numri telefonik për Kosovën (+383) dhe rregullimin e funksionimit të operatorit të telefonisë mobile nga Serbia në veri të Kosovës. Në nëntor të vitit 2016, në negociatat në Bruksel u ra dakord për zbatimin e mëtejshëm të kësaj marrëveshjeje, dmth. versioneve të saj nga viti 2013 dhe 2015 respektivisht. Kjo marrëveshje ka të bëjë edhe me funksionimin e Telekomit të Serbisë në Kosovë përmes kompanisë MTS SH.P.K. dhe rregullon mundësinë e tarifimit të thirrjeve mes Serbisë qendrore dhe atyre në Kosovë sipas tarifave ndërmjet qyteteve. Duke u nisur nga fakti se komunikimi dhe përdorimi i telefonisë kanë të bëjnë me jetën e përditshme të qytetarëve në aspektin e komunikimit të përditshëm, i cili mbështet pretendimin tonë se interesi i qytetarëve për zbatimin praktik të kësaj marrëveshjeje është shumë i lartë.

Marrëveshja për Energji nënkupton formimin e dy ndërmarrjeve (EPS Trgovina dhe Elektroserver) që do të bënin shpërndarjen dhe arkëtimin e pagesave për energji elektrike në komunat Zveçan, Severna Mitrovica, Zubin Potok dhe Leposaviq. Hulumtimi i kryer në vitin 2016 nga OJQ Radio Mir dhe Ekipi për hulumtime shoqërore tregon që qytetarët nuk kanë njohuri për dispozitat e Marrëveshjes së Energjisë¹.

Qëllimi i këtij studimi është që përmes analizës së marrëveshjeve të arritura dhe rrjedhës së zbatimit të tyre qytetarëve t'u ofrohen më shumë informata se si këto marrëveshje do të ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Studimi gjithashtu përfshin rekomandime për vendimmarrësit dhe qytetarët që në të ardhmen zbatimi i marrëveshjes të jetë më transparent.

1 "Të pyesim veriun – Hulumtimi i qëndrimeve të qytetarëve të veriut të Kosovës për shërbimet publike dhe komunale" të cilin gjatë vitit 2016 e ky kryer OJQ Radio MIR në katër komunat në veri të Kosovës ka treguar se 64.5% të të anketuarve nuk janë të njohuar me përmbajtjen e Marrëveshjes së Brukselit për Energjinë.

TELEKOMUNIKIMET



Marrëveshja e Telekomunikacionit, më shumë se cilado tjetër deri më tani, ka hasur në reagime të rëndësishme nga publiku në Kosovën e veriut. Ndërsa marrëveshjet e deritanishme kanë prekur kategori të caktuara të popullsisë gjatë realizimit, kjo marrëveshje ka prekur një numër të madh njerëzish nga kategori të ndryshme sociale, domethënë të gjithë ata që kanë telefon fiks dhe/ose mobil. Rezultati më i rëndësishëm i zbatimit të kësaj marrëveshje është krijimi i “MTS SH.P.K.”, e cila është përgjegjëse për telekomunikacionin në zonat serbe të Kosovës, në veçanti në komunitet e Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Me themelimin e kësaj kompanie në Kosovë, operatorët celularë VIP dhe Toleron pushuan së funksionuari, me çka kompania e sapokrijuar arrin monopol në telekomunikacion në veri të Kosovës. Përkundër mangësive në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për qytetarët e Kosovës që jetojnë në zonat me shumicë serbe shërbimet e kësaj kompanie janë ende më të favorshme sesa operatorët e tjerë të Kosovës (IPKO dhe VALA). Arsyeja për këtë është çmimi më i ulët i bisedave me Serbinë. Megjithatë, kjo kompani funksionon në bazë të lejes së përkohshme për punë dhe ende nuk dihet se çfarë do të ndodhë pas kalimit të periudhës prej dy vitesh, për të cilën MTS SH.P.K-së i është dhënë licenca për punë. Ashtu si Procesi i Brukselit në përgjithësi, edhe kjo marrëveshje është jo-transparente dhe prandaj lë hapësirë për interpretime të ndryshme nga negociatorët, si dhe nga publiku i gjerë. Qytetarët që morën pjesë në anketë nuk janë të informuar për hapat e mëtejshëm lidhur me zbatimin e marrëveshjes. Për hapat e mëtejshëm rreth zbatimit të marrëveshjes për telekomunikacionin nuk janë të informuar sa duhet as të punësuarit në kompaninë MTS SH.P.K, ish-punëtorët e Telekomit të Serbisë, por se cilat janë detyrat e tyre kanë marrë vesh gjatë zbatimit të marrëveshjes. Kur përdoruesit, të cilët nuk e kanë bërë me kohë çregjistrimin nga njëra dhe regjistrimin në kompaninë tjetër, janë shkyçur, të punësuarit në MTS SH.P.K nuk kanë ditur menjëherë se si të veprojnë në këtë situatë dhe cila është procedura për të ri-aktivizim dhe ri-regjistrim të përdoruesve, por qytetarëve u kanë thënë të vijnë të nesërmen, sepse ende nuk kishin marrë udhëzime se si të vepronin².

2 Këtë e kanë vërtetuar qytetarët që kanë qenë pjesëmarrës të fokus grupeve e edhe autorët e hulumtimit „Terri dhe qetësia pas Marrëveshjes së Brukselit“ kanë pasur përvoja të ngjashme gjatë bartjes së regjistrimit në MTS SHPK.



NUMRI PËR KOSOVËN



DAKORDUAR	AFATET	REZULTATET
<p>DHËNIA E NUMRIT TRE-SHIFROR PËR KOSOVËN</p> <p>OPERATORËT JANË ZOTUAR SE DO T'I ZVOGËLOJNË SHPENZIMET</p>	<p>31. 12. 2013 – afati i parë</p> <p>15. 08. 2017 – afati i dytë</p> <p>01. 01. 2016 – adresimi ITU</p> <p>01. 03. 2016. – dhënia e numrit tre-shifror</p> <p>15. 03. 2016. – zvogëlimi i shpenzimeve të thirrjeve lokale</p>	<p>Në fillim të vitit 2016 Austria ka kërkuar numrin për Kosovën, Serbia ka dhënë pëlqimin në dhjetor 2016</p> <p>15. 12. 2016 ITU ndanë +383 si numër territorial për thirrje, të cilin Serbia i a jep Kosovës në shfrytëzim</p> <p>15. 01. 2017 Autoriteti Rregullator i Komunikimeve në Kosovë i jep MTS shpk leje të përkohshme për telefoninë mobile</p> <p>02.02.2018 fillon së funksionuari numri +383</p>

Një nga marrëveshjet për të cilën ka pasur polemika të veçanta është dhënia e prefiksit Kosovës. Me këtë marrëveshje parashihet që Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimit (International Telecommunication Union, në tekstin vijues ITU), në përputhje me standardet, parimet dhe orarin e ITU ti ndajë Kosovës një prefiks. Në kuadër të këtyre negociatave, operatorët gjithashtu janë zotuar të ulin kostot e tyre në nivelin e tarifave lokale. Afati i parë për gjetjen e një zgjidhje kompromisi për prefiksin e Kosovës ka qenë dhjetori i vitit 2013 afat ky i cili më me Planin e Veprimit 2015 u shty deri më 15 gusht 2017. Në këtë Plan Veprimi u ra dakord gjithashtu që Autoriteti Rregullativ dhe i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (në tekstin e mëtejme ARKEP) të zhvillojë një strategji për bartje dhe plan të ri të numeracionit deri më 15 maj 2016, si dhe që operatorët të zvogëlojnë koston e thirrjeve lokale deri nga mesi i marsit 2016. Organet rregullatore, sipas të njëjtit plan, duhet të harmonizojnë përdorimin e spektrit të radio-frekuencave të telefonisë mobile deri më 15 prill të vitit 2016.

Ne këtu, siç duket nga zhvillimi i deritanishëm i ngjarjeve, kemi njerëz që marrin vendime shumë të rëndësishme e që nuk kanë ide se kush është ulur përballë tyre

Fokus grupi Zveçan

REZULTATET

Prefiksin për Kosovën e ka kërkuar, nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimit (ITU), Republika e Austrisë në fillim të vitit 2016, për çka Serbia e ka dhënë pajtimin në dhjetor të vitit të njëjtë. Gjegjësisht, me numrin nuk mund të disponojë Kosova sepse ITU përbëhet vetëm nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara (KB). ITU më 15 dhjetor 2016 ia ka ndarë Serbisë prefiksin +383 si prefiks territorial, të cilin Serbia ia bart Kosovës në përdorim (ARKEP është administratori i vetëm), që është vërtetuar edhe në buletin zyrtar të Unionit. Në të njëjtën kohë Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të Kosovës më 15 janar 2017 i ka dhënë MTS SH.P.K një licencë të përkohshme për telefoni mobile (për 2 vjet) dhe një licencë për shërbime të telefonisë fikse (licencë të përhershme) në Kosovë. Këto marrëveshje janë zbatuar dhe afatet janë vendosur një muaj më parë në takimet shumëditore të ekipeve negociuese në Bruksel.

Prefiksi telefonik për Kosovën (383) filloi të funksionojë më 2 shkurt 2018. Për operatorët e Kosovës, VIP dhe VALA do të pasojë një reduktim i ndjeshëm i shpenzimeve, pasi ata nuk do të paguajnë më për përdorimin e prefikseve të shteteve tjera. Gjegjësisht deri në atë kohë janë përdorur prefiksat e huaj, si prefiksi i Monakos (377) dhe Sllovenisë (386) për telefoninë mobile dhe prefiksi i Serbisë për telefoninë fikse (381).

Çmimi i bisedave për qytetarët e veriut të Kosovës tani për tani do të mbetet i pandryshuar, por është e paqartë se si do të trajtohen thirrjet pas kalimit të dy viteve. Bisedat tani do të trajtohen si biseda ndërmjet qyteteve të ndryshme në Serbi dhe nuk do të tarifohen si aso në mes dy vendeve, pavarësisht faktit se për të krijuar lidhjen duhet të formohet prefiksi i territorit. Megjithatë, problemi më i madh për qytetarët e Kosovës të cilët jetojnë në komunitetet shumicë serbe dhe që janë konsumatorë të shërbimeve të kompanisë MTS SH.P.K, është mundësia potenciale që pas kalimit të dy viteve të bisedat me Serbinë të fillojnë të tarifohen me çmime më të larta romingu se sa çmimet e tanishme.

Ashtu siç janë interpretuar në përgjithësi negociatat në Bruksel, edhe kjo marrëveshje u shoqërua me interpretime të dyfishta nga negociatorët dhe me reagime negative nga opozita në Prishtinë dhe Beograd. Pala e Kosovës marrjen e prefiksit telefonik e ka karakterizuar si forcim të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, ndërsa pala serbe ka theksuar se ai është një prefiks për krahinën autonome të Serbisë - Kosovën e Metohinë, si një zonë gjeografike³. Gjatë negociatave, Beogradi vazhdimisht është thirrur në rregullat e ITU, ndërsa Prishtina ka kërkuar mënyra alternative për të marrë prefiksin përmes Organizatës Ndërkombëtare për mënyrat alternative të rregullimit të sektorit të komunikimit (ICANN - Korporata Ndërkombëtare për Caktimin e Emrave dhe Numrave)⁴.

3 <http://www.kim.gov.rs/lat/v2213.php>

4 http://kossev.info/strana/arhiva/kosovo_trazi_alternativne_nacine_za_pozivni_broj_i_internet_domen___pomoci_ce_i_ambasade/4167



SINJAI TELEVIZIV



DAKORDUAR	AFATET	REZULTATET
<p>HARMONIZIMI I SPEKTRIT PËR TELEFONI MOBILE DHE SINJAL TELEVIZIV.</p> <p>HARMONIZIMI I FREKUENCAVE DIGJITALE.</p>	<p>15. 04. 2016. – Harmonizimi i spektrit digjital dhe analog.</p>	<p>Në nëntor të vitit 2016 është arritur dakordimi që një pjesë e spektrit digjital të rezervohet për mediat në gjuhën serbe, respektivisht prezencën e operatorëve serb për bartjen e sinjaleve televizive.</p>

Në Bruksel, u dakordua harmonizimi i përdorimit të spektrit të GSM (Sistemi Global për komunikime mobile) dhe për sinjal televiziv, duke përfshirë transmetimin digjital tokësor, pa mbuluar kufirit/kufirin administrativ të anës tjetër me sinjal ndërkombëtar si dhe sinkronizimin e frekuencave dixhitale. Afati i paraparë për këtë marrëveshje ka qenë data 15 prill 2016. Në takimet disaditore në Bruksel në nëntor të vitit 2016, u ra dakord që një pjesë e spektrit dixhital të jetë e rezervuar për mediat në gjuhën serbe, përkatësisht për prani të operatorëve serb për transmetimin e sinjaleve televizive.



TELEFONIA FIKSE DHE MOBILE



DAKORDUAR

THEMELIMI I KOMPANISË, DEGËS SË FIRMËS SË SERBISË, SIPAS LIGJEVE TË KOSOVËS, E CILA DO TË MARR LICENCËN E PLOTË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË TELEFONISË FIKSE.

THEMELIMI I KOMPANISË E CILA DO TË FITOJ LEJEN E PËRKOSSHME PËR OPERACIONET EKZISTUESE TË TELEFONISË MOBILE.



AFATET

Janar 2015 – leje e përkohshme nuk do të duhej të skadonte para këtij afati

15. 03. 2016 – kontratat e ndërsjella për interkoneksion të operatorëve fiks dhe mobil



REZULTATET

12. 10. 2015 – u themelia kompania MTS shpk në pronësi të Telekom Srbija AD

16. 12. 2016 – MTS shpk merr licencën e përhershme për telefoni fikse dhe autorizim të përkohshëm për telekomunikime mobile nga ARrKEP

06. 01. 2017 – lëshohet sinjali i MTS telefonisë mobile për shfrytëzuesit në Shtërpcë dhe Graçanicë

01. 05. 2017 - Telenor dhe Vip ndërprejnë emetimin e sinjalit në Kosovë

Kur është fjala për telefoninë fikse dhe mobile, u ra dakord që të themelohet një kompani që do të marrë licencë të plotë për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe leje të përkohshme për operacionet aktuale, kur bëhet fjalë për telefoni mobile. Është planifikuar që licenca e përkohshme për telefoninë mobile të lëshohet jo më vonë se më 15 shkurt 2016. Autoritetet e Kosovës, pas kësaj, do të lëshojnë një licencë të re, të plotë dhe të pakufizuar për telefoni mobile, si rezultat i tenderit/ankandit në përputhje me standardet e BE. Afatet e parapara për këto marrëveshje janë 13 tetori 2015 për regjistrimin e një kompanie të re dhe Marsi 2016 për marrëveshjet e ndërsjella për interkoneksion midis operatorëve fiks dhe celular. Kompania e re për të cilën është përpjekur pala serbe gjatë negociatave nuk mund të fillojë punën deri kur ARKEP-i (Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare i Kosovës) të jep autorizim për shërbime të telefonisë fikse dhe autorizim të përkohshëm për shërbimet e telefonisë mobile, për të cilat afati i paraparë me marrëveshje është 1 mars 2016. Marrëveshja parashikon gjithashtu që negociatat mbi një marrëveshje të interkoneksionit midis kompanisë së re dhe operatorëve të tjerë të autorizuar duhet të përfundojnë deri më 15 mars 2016. MTS SH.P.K është dashur të dorëzojë dokumentacionin për rritjen e kapitalit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejme ARBK) deri më 26 nëntor 2016. Afati i paraparë për aprovim dhe regjistrim nga ARBK është 29 nëntor 2016.

Vetëm frikësohen se a do të mund të zgjatet ai afat. Që pala shqiptare të mos thotë ju jeni në roming. Ne tani nuk jemi në roming, por nëse nuk zgjatet atëherë do të jemi në roming (me Serbinë)“

REZULTATET

Kompania MTS shpk është regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës më 12 tetor 2015, të njëjtën ditë kur edhe është paraqitur kërkesa për themelimin e kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar⁵. Pronar i kompanisë është Telekom Srbija AD Beograd. Aktiviteti kryesor është telekomunikimi me kablo, kurse dytësor pa kablo.

Kompania është e regjistruar në regjistrin e operatorëve të komunikimeve elektronike më 16 dhjetor 2016, duke marrë licencë të përhershme të telefonisë fikse dhe autorizim të përkohshëm për telekomunikim mobil nga Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP). Regjistrimi pasoi vendimin e Qeverisë së Kosovës, më 15 dhjetor 2016, i cili është dashur të hyjë në fuqi kur ITU t'ia ndajë Kosovës prefiksionin (383). Të dyja palët kanë përmbushur pjesën e tyre të marrëveshjes, të arritur një muaj më parë në Bruksel, brenda afatit të paraparë.

Operatorët ekzistues në Kosovë, Telekom i Kosovës/VALA dhe IPKO, kanë pasur ankesa për ndarjen e licencave për kompanitë e reja të telekomunikacionit. Këto kompani besojnë se operatorët nga Serbia, MTS dhe Telenor, për më shumë se një dekadë kanë operuar ilegalisht në Kosovë, përkatësisht nuk kanë paguar taksat e nevojshme dhe me këtë kanë dëmtuar buxhetin e Kosovës në vlera milionëshe, për dallim nga afarizmi i operatorëve kosovarë të cilët kanë punuar në përputhje me rregulloret në fuqi.

Opozita në Serbi gjithashtu ka vërejtje ndaj themelimit të MTS shpk në Kosovë. Në radhë të parë, është kritikuar regjistrimi dhe funksionimi i kompanisë në përputhje me dispozitat e Kosovës. Një nga pasojat më serioze, sipas mendimit të tyre, është ndryshimi i shtetësisë së punonjësve të rinj në MTS shpk. Gjegjësisht fjala është për ish-punonjësit e Telekom Srbija në Kosovë të cilët ishin të detyruar të lidhin një kontratë të re punësimi me një kompani të re të telekomunikacionit. Në mënyrë që të respektohet korniz ligjore e Kosovës në këtë fushë, dhe që të lidhet kontrata, kandidatët duhet të kenë dokumente personale identifikimi të Kosovës, të cilat i marrin vetëm si qytetarë të Kosovës.

Si argumente kundër janë theksuar edhe problemet që shfrytëzuesit e shërbimeve të Telekomit i kanë gjatë pagesës për shërbimet në Serbi, siç janë parkimi, raportet bankare, SMS humanitare etj. Këto shërbime në Serbi

Përshtypja ime lidhur me tërë këtë konfuzion në lidhje me telefonat mobilë është se nuk ka më kufi të shkëljes së të drejtave qytetare.

Fokus Grupi Leposaviq

nuk do të aktivizohen deri në fund të të ashtuquajturës periudhë të migrimit, dmth. deri në skadimin e autorizimit të përkohshëm për telekomunikacion mobil për periudhën prej dy vjetësh. Deri në fund të periudhës së migrimit, përdoruesit e MTS në Kosovë do të përdorin sistemin e numrave të dyfishtë, që është, (0)47 dhe (06X) në të njëjtën kartë SIM. Numri 06x do të jetë primar deri në fund të periudhës së migrimit, pas së cilës numri primar do të jetë 047. U ra dakord që MTS shpk të regjistrojë të gjithë abonentët (kartat SIM), qoftë me parapagim, qoftë postpaid, me mundësi vazhdimi, brenda tre muajve pas lëshimit të lejes së përkohshme.

Negociatorët serbë, si arritje të rëndësishme përmendin ruajtjen e pronës së “Telekom Srbija” në Kosovë, e cili u transferua në kompaninë e sapoformuar MTS shpk. Gjegjësisht, pala serbe nuk e pranoi marrëveshjen e formuluar nga Kosova në tetor 2016, ku pronësia e Telekomit duhej të ishte në pronësi të Kosovës. Transferimi i asetëve nga Telekom Srbija në MTS shpk është vërtetuar me pikën 11 të Konkluzave të ndërmjetësit të BE në lidhje me telekomunikimet nga 13 nëntori 2016.

MTS shpk aktualisht ka katër degë në Kosovë: Mitrovica Veriore, Graçanicë, Ranillug, Shtërpçë. MTS gjithashtu në bazë të marrëveshjeve të datës 18 nëntor 2016 - “Plotësimi i konkluzioneve” ka marrë edhe 8 stacione të reja bazë për të mbuluar të gjitha enklavat në Kosovë, përveç 22-ve ekzistuese. Pala serbe në kërkesën për sigurimin e stacioneve bazë shtesë është thirrur në planin e veprimit në të cilin thuhet se është e detyruar të ofrojë të njëjtin nivel shërbimesh për abonentët e tij në Kosovë. Stacionet e reja bazë janë vendosur jashtë veriut të Kosovës, me çka edhe në komunat populsi shumicë serbe është mundësuar sinjali i telefonisë mobile si dhe shfrytëzimi i teknologjive 2G, 3G dhe 4G. Telekom Srbija më parë kishte 70 stacione bazë, shumica e të cilave u rrënuan. Gjithashtu, në fund të vitit 2016, ARKEP ka ndarë 60.000 numra mobil dhe 74.000 numra fiks për MTS-në si dhe 30 lokacione për instalimin e antenave anembanë Kosovës. Në natën e Krishtlindjes, më 6 janar 2017, u lëshua sinjali i telefonisë mobile MTS përdoruesve në Shtërpçë dhe Brezovicë. Në fund të marsit u aktivizua stacioni i ri bazë, dhe nga 5 maji u lëshuar sërish sinjali i telefonisë fikse

Nëse ndonjë gjë do të varej prej neve, atë para kësaj do të bënin ndonjë anketë, hulumtim, marrje të mendimeve të njerëzve...

MTS në të gjitha mjediset me populsi shumicë serbe në Kosovën qendrore. Sinjali në Kosovën qendrore është ndërprerë më 26 shtator 2010. MTS shpk u bë operatori i vetëm serb që ka licencë për të bërë biznes në territorin e Kosovës, sepse Telenor dhe Vipmobile kanë ndërprerë sinjalin në Kosovë me 1 maj 2017. Dallimi në mes të dy operatorëve është se Vip klientët e vet i ka informuar në lidhje me kushtet e reja të shërbimit, të cilat tani kalojnë përmes stacioneve bazë të MTS shpk, ndërsa

abonentët e Telenor që jetojnë në Kosovë, me fillimin e punës së kompanisë së re të telekomunikacionit janë privuar nga shfrytëzimi i shërbimeve të operatorit të deri atëherëshëm. Në ditët e para të punës të kompanisë MTS shpk shfrytëzuesit e shërbimit të rrjetit Telenor, të cilët vijnë nga Serbia në Kosovë ishin krejtësisht pa sinjal celular pas kalimit të kufirit/kufirit administrativ. Kjo më vonë u rregullua në mënyrë të tillë që shfrytëzuesit e rrjetit, që vijnë nga Serbia, kanë sinjal mobil në të gjithë territorin e Kosovës dhe jo vetëm në katër komunat veriore (siç ishte më parë rasti) por me çmime të romingut.

PROBLEME ME FUNKSIONIMIN E TELEFONISË NË VERI TË KOSOVËS

Funksionimi i telefonisë mobile në veri të Kosovës ende nuk është rregulluar plotësisht. Ndonëse procesi i ri-regjistrimit të përdoruesve që përdorin shërbimet e telefonisë celulare postpaid ka përfunduar brenda kompanisë MTS shpk, ende nuk është rregulluar çështja e shfrytëzuesve prepaid. Qytetarët e Kosovës që përdorin këtë lloj shërbimi ende paguajnë për mbushjet e telefonave mobil me dinarë. Tregues se transferimi i shfrytëzuesve nga Telekom Srbija në MTS shpk ende nuk është kryer plotësisht është se të gjithë përdoruesit ende pranojnë mesazhe për oferta roming në dinarë kur udhëtojnë jashtë vendit, ndërsa kompania e re u jep atyre faturat në euro. Se zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit ka rrjedhë në mënyrë jotransparente dhe pa përgatitje adekuate tregojnë edhe problemet e shumta që kanë lindur në këtë proces. Edhe punonjësit e MTS shpk, ish-punonjësit e Telekom Srbija, nuk mund të reagonin në kohë për problemet e përdoruesve të shërbimeve telefonike, pasi që ata vetë nuk ishin të njoftuar me hapat e mëtejshëm por gjatë punës kanë zgjidhur problemet që kishin përdoruesit. Për shembull, përdoruesit të cilëve u ishte ndërprerë shërbimi i telefonisë mobile për shkak të vonesave në procesin e regjistrimit, në ditët e para iu mohuan informatat se si të reregjistrohen pas skadimit të afatit të fundit të caktuar për reregjistrim.

Qytetarët e veriut të Kosovës ndjenë vështirësitë e para në funksionimin e telefonisë mobile që në ditët e para, madje edhe para procesit të ri-regjistrimit në kompaninë e re. Kjo kryesisht lidhet me pamundësinë për të përdorur shërbimet që ata më parë i kishin në dispozicion përmes SMS (pagesa për parkim në Serbi, pjesëmarrja në aksione humanitare, kontrollimi i bilancit në llogarinë bankare, etj).

Një nga problemet që po u shkakton vështirësi qytetarëve është evidentimi i paqartë të pagesës për shërbimet e telekomunikacionit. Gjegjësisht, ndodh që përdoruesit të shkyçen nga rrjeti i telekomunikacionit, megjithëse kanë paguar të gjitha faturat, ndërsa disa përdoruesve u ka ndodhur të mos shkyçen edhe epse kanë më shumë se dy fatura të papaguara. Këto vështirësi i kanë pasur më së shumti qytetarët që i kanë paguar faturat në mënyrë elektronike. Ri-kyçja, edhe

pse nuk është për shkak të gabimit të blerësit i mbetet barrë atij dhe kushton dy euro. Disa qytetarë madje duhej të paguanin ri-kyçjen e telefonit.

Problemet ekzistojnë edhe pas ndryshimit të valutës së pagesave, sepse qytetarët e moshuar që marrin pension nga Serbia dhe të gjithë ata që punojnë në institucionet serbe⁶ kanë problem me pagesën e shërbimeve të telekomunikacionit, sepse të ardhurat i kanë në dinarë, që i bie se kërkohet zëvendësimi i dinarit me euro për të paguar faturën telefonike. Në këtë mënyrë ata paguajnë edhe çmimin e konvertimit të valutës.

Gjatë ri-regjistrimit nga Telekom Srbija në MTS shpk, ishte e domosdoshme që qytetarët të kenë letërnjoftim të Kosovës. Në këtë rast është bërë një koncesion dhe ri-regjistrimi është bërë i mundur me premtimin se përdoruesi që nuk e ka këtë dokument brenda gjashtëdhjetë ditëve do t'a paraqesë atë. Sidoqoftë, tani për tani nuk ka pasur këmbëngulje për këtë çështje pasi që ka një numër të madh të qytetarëve të cilët nuk janë në gjendje të realizojnë të drejtën e tyre për dokumente personale sipas ligjeve të Kosovës⁷.

GRUPI PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES

Në kuadër të bisedimeve për telekomunikacionin u ra dakord që të krijohet grupi për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, dhe nëse ka nevojë për këtë, edhe me ndihmën e Bashkimit Evropian (BE). Qëllimi i krijimit të këtij grupi është hartimi i një plani veprimi për zbatimin e marrëveshjes. Me Planin e Veprimit të vitit 2015 ishte rënë dakord se hartimi i planit të plotë do të përfundojë deri më 29 qershor dhe se do të pranohet deri më 15 tetor 2017. Afati i fundit për formimin e tre nëngrupeve punuese ishte deri më 15 janar 2016.

REZULTATET

Plani i Veprimit për zbatimin e marrëveshjes së vitit 2013 u miratua më 25 gusht 2015. Me të janë precizuar aktivitetet e marrëveshjeve të mëparshme dhe përcaktuar afatet për zbatimin e tyre. Nuk ka informata për hartimin e planit të plotë të veprimit dhe formimin e nëngrupeve punuese - organe rregullatore, operatorë, shërbime postare.

6 Çfarë e ardhme na pret, institucionet publike të Republikës së Serbisë në veri të Kosovës – Insituti për zhvillim ekonomik territorial (InTER): http://www.lokalnirazvoj.org/upload/Publication/Documents/2017_08/Javne_institucije_i_ustanove_Republike_Srbije_na_severu_Kosova.pdf

7 Qasja në dokumente në Kosovë – pengesa kryesore në integrimin e bashkësive jo-shumicë në Kosovë, AKTIV: [http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Pristup_li%C4%8Dnim_i_putnim_dokumentima%20\(1\).pdf](http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Pristup_li%C4%8Dnim_i_putnim_dokumentima%20(1).pdf)

ENERGJIA

3

Negociatat e para midis Beogradit dhe Prishtinës mbi energjinë filluan qysh në vitin 2011, kur në krye të ekipeve negociatore teknike ishin Borisllav Stefanoviq dhe Edita Tahiri. Gjashtë vjet më vonë, nuk ka përmirësim të dukshëm në këtë fushë. Ashtu si marrëveshjet e tjera në kuadër të negociatave të Brukselit edhe kjo ndiqet nga një vello e jotransparencës dhe interpretimeve të ndryshme nga ana e negociatorëve nga Beogradi dhe Prishtina. Ajo për çfarë negociatorët pajtohen është se pengesa kryesore në zbatimin e marrëveshjes është mungesa e themelimit dy kompani: EPS Tregtia dhe ELEKTROSEVER-i të cilat duhet të jenë përgjegjëse për shpërndarjen dhe mbledhjen e pagesë së energjisë elektrike në veri të Kosovës. Negociatorët serbë theksojnë se Prishtina nuk e ka përbushë zotimin e saj për themelimin e kompanive, ndërsa autoritetet e Kosovës thonë se Serbia refuzon që në statutin e shoqërisë të përmendet se se ato e kryejnë aktivitetin e tyre në territorin e Kosovës, edhe pse marrëveshjet parashohin respektimin e legjislacionit të Kosovës. Ndryshe nga marrëveshja e telekomunikacionit, fusha e energjisë paraqet një sfidë shumë më të madhe në zbatim, sepse është një rrjet më kompleks të infrastrukturës dhe sistemit të mirëmbajtjes.

Në krahasim me çmimin cilësia është e shkëlqyeshme


GJENDJA NË FUSHËN E ENERGJISË NË VERI TË KOSOVËS

Elektroekonomia e Serbisë që nga viti 1999 nuk menaxhon me kapacitetet e energjisë elektrike dhe minerare në territorin e Kosovës⁸, ku përfshihet edhe Elektrokosmet, një kompani që qytetarëve të veriut të Kosovës ua dërgon faturat për energjinë elektrike të konsumuar. Kjo kompani u dërgon faturat e energjisë elektrike qytetarëve të Leposaviqit, Mitrovicës së Veriut dhe Zubin Potokut. Komuna e Zveçanit është e përjashtuar nga ky sistem dhe me detyrën për furnizim me energji elektrike në këtë pjesë është i ngarkuar Kombinati Minerar, Metalurgjik, Kimik Trepça, me shenjen e të cilit qytetarëve u vijnë faturat për energjinë elektrike të konsumuar.

Që nga viti 1999, shumica e qytetarëve të veriut të Kosovës, për shkak të vakumit ligjor, nuk i paguajnë borxhet e tyre për energjinë e konsumuar. Sipas një sondazhi të kryer nga Radio Mir dhe Ekipi i Kërkimeve Sociale në vitin 2016, më shumë se gjysma e të anketuarve kanë borxh të energjisë elektrike që është më i vjetër se tre vjet. Nga ana tjetër, çdo i dhjeti i anketuar tha se familja e tij i kishte paguar të gjitha kërkesat për këtë shërbim. Numri i njëjtë i të anketuarve ka borxh më pak se një vjet të vjetër.

Pagesa e energjisë elektrike

A e paguani rrymën rregullisht?




Arsyet për mospagesë

- 41,2% Nuk kam mjaft para
- 43,9% Çmimi i shërbimit është tepër i lartë
- 33,4% Çmimi i shërbimit është tepër i lartë krahasuar me cilësinë e shërbimit
- 29,6% Nuk jam i kënaqur me shërbimin e ofruar
- 38,0% E di që nuk do të dënohem
- 60,6% Shumica e madhe nuk paguan

Në përgjithësi, arsyeja më e shpeshtë për mospagesë të energjisë elektrike është rezultat i qëndrimit të përdoruesve se praktika e mospagesës nuk është joetike, ose të besuarit se mospagesa nuk do të gjykohej as nga shumica e qytetarëve, e as nuk do të ketë nisje të procedurave për padi ose shkurtim të furnizimit as nga vetë Elektrodistribui. Përveç mosndëshkimit dhe pranueshmërisë joformale


të mospagesës nga ana e mjedisit, Grupi i dytë i arsyeve mund të klasifikohen si pakënaqësi me shërbimin apo çmimin, përkatësisht pakënaqësisë me raportin çmim-cilësi.

Gatishmëria për të paguar



Kur është fjala për furnizimin me energji elektrike, qytetarët edhe në hulumtimin e vitit 2017 si probleme kryesore konfirmuan qëndrimet e hulumtimit të mëparshëm: rrjeti i dobët dhe i vjetruar elektrik, sidomos në fshatra, ndriçimi i dobët i rrugëve dhe ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike. Të anketuarit deklarojnë ndryshime pozitive në fushën e furnizimit me energji elektrike vetëm në raste më të rralla dhe mungesën e reduktimeve.

Problemet në furnizim me energji elektrike



Ndërsa qytetarëve të veriut të Kosovës faturat u vijnë nga kompania publike Elektrokosmet-i dhe nga Trepça, të cilat shumica nuk i paguajnë, qytetarëve në jug të lumit Ibër, duke përfshirë komunat me popullatë shumicë serbe, faturat u vijnë nga KEDS dhe janë të detyruar të paguajnë rregullisht ato.

Me qëllim të ndryshimit të situatës në veri të Kosovës, kur është fjala për të paguar për shërbimet e furnizimit me energji elektrike, Qeveria e Serbisë ka nxjerrë vendim për themelimin e Grupit Punues për krijimin e një sistemi të mbledhjes së pagesave për energji elektrike, i cili ka hyrë në fuqi më 31 tetor 2015.

Gjithashtu, në shkurt të vitit 2015, është realizuar një fushatë e ndërmarrjes publike Elektrokosmet ku qytetarëve të veriut të Kosovës u janë dorëzuar faturat me një paralajmërim për shkyçe dhe me borxhin për energjinë elektrike të konsumuar për periudhën nga 1 dhjetori 2012 deri më 31 dhjetor 2014 dhe me afat të fundit për pagesë deri në 4 Mars 2015. Ky aksion është ndalur pa shpjegime. Kishte edhe thirrje për qytetarët nga Elektrokosmet-i për të legalizuar kyçjen në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike të EPS në kushte më të favorshme deri në një afat të caktuar, të cilës gjithashtu nuk i ishin përgjigjur.

Duke marrë parasysh theksimin nga Elektroekonomia e Serbisë se kjo kompani publike nuk menaxhon sistemin energjetik dhe minierat në territorin e Kosovës⁹ mbetet i paqartë juridiksioni mbi këtë sistem në territorin e veriut të Kosovës. Në anën tjetër, autoritetet përgjegjëse për sistemin e energjisë sipas legjislacionit të Kosovës pohojnë se humbjet për energjinë elektrike të shpenzuar në veri paguhen nga përdoruesit në pjesët tjera të Kosovës të cilët rregullisht e paguajnë faturën e energjisë elektrike¹⁰.

Veriu i Kosovës furnizohet me energji elektrike nga largpërçuesit e energjisë elektrike të termocentraleve të Kosovës dhe pjesërisht me energji elektrike nga Serbia, përmes Novi Pazarit.



9 Elektroekonomia e Serbisë uebfaqja: <http://eps.rs/Pages/Ogranci.aspx>

10 Raporti i REL për energjinë elektrike: <https://www.slobodnaevropa.org/a/struja-kosovo-sever-trosi-jug-placa/28531788.html>

RRJEDHA E NEGOCIATAVE PËR ENERGJINË

Marrëveshja e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve e prillit 2013 nuk parashihte zgjidhje konkrete në fushën e energjisë, përveç se u theksua se bisedimet mbi këtë temë do të intensifikoheshin dhe afati përfundimtar për përfundimin e këtyre negociatave ishte 15 qershori i të njëjtit vit¹¹. Marrëveshjet e para konkrete midis delegacioneve të Beogradit dhe Prishtinës për energjinë u arritën më 8 shtator 2013, Aranzhimet për Energji. Kjo marrëveshje duhet të zgjidhte çështjen e shpërndarjes dhe mbledhjes së pagesës për energjinë elektrike në komunat e Mitrovicës, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Në përputhje me këtë u dakordua që të themelohen kompanitë “EPS trgovina” dhe “Elektrosever”.

Vlen të përmendet se secila palë në fazën e dytë të negociatave për Energji ka deklaruar se beson që prona në territorin e Kosovës në pronësi të saj. Çështjet e pronës janë lënë anash, duke shkaktuar ngecje të reja në negociata, duke pasur parasysh se problemi i energjisë nuk mund të zgjidhet pa adresimin e çështjes së pronësisë.

Me Marrëveshjet e Brukselit për energjinë nga shtatori i vitit 2013 dhe nënshkrimin të konkluzioneve të ndërmjetësit të BE-së për zbatimin e marrëveshjeve për energji të datës 25 gusht 2015, bëhen përpjekje për të rregulluar fushën e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike. Edhe pse në

Nuk kam kut ë informohem. I shoh rrjetet sociale, mediat lokale. Kam parë disa tituj në lidhje me këtë marrëveshje. Shoh vetëm titujt, se kanë biseduar për këtë. Por asgjë më shumë se kaq. Kjo është e gjitha që dëgjojmë.

ndërkohë janë nënshkruar marrëveshja kornizë për bashkëpunim në mes të operatorëve të sistemit të transmisionit dhe tregjeve të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Rrjetit Energjetik të Serbisë (EMS) në Vjenë më 12 shkurt 2014, një nga pikat kyçe të kësaj marrëveshjeje është demarkacioni i kufirit elektroenergjetik ndërmjet dy sistemeve, duke filluar nga 1 janari 2015¹². Në tetor të vitit 2015, KOSTT ka nënshkruar *Connection Agreement* me 29 operatorët e ENTSO-E “, me kusht që

Fokus grupi Mitrovica e Veriut

11 Zyra për Kosovë e Metohi, Marrëveshja e parë për parimet që rregullojnë normalizimin: <http://www.kim.gov.rs/p03.php>

12 http://www.kostt.com/website/index.php?option=com_content&view=article&id=783%3A18-septembar-2014-potpisan-operativni-sporazum-izmeu-operatora-prenosnog-sistema-kosova-kostt-i-srbije-ems-&catid=45%3Akomunikata-srb&Itemid=28&lang=sr

kompania" ELEKTROSEVER "të marrë më parë licencën për furnizim me energji elektrike dhe të bëhet funksionale¹³."

Nga perspektiva e qytetarëve të katër komunave në veri të Kosovës, rrjedha e deritanishme e negociatave, si dhe përmbajtja e tyre janë krejtësisht të panjohura. Përveç njohurive të përgjithshme se kjo fushë është pjesë e negociatave, shumica e qytetarëve nuk kanë informata tjera. Informatat kryesisht merren përmes rrugëve joformale, bisedave reciproke ose bisedave me të punësuarit në sektorin e energjisë dhe furnizimit me energji elektrike, ose nëpërmjet mediave.

THEMELIMI I KOMPANIVE TË REJA

Qeveria e Serbisë ka dhënë pëlqimin e saj për themelimin e "EPS Trgovina" në Mitrovicën e Veriut më 30 tetor 2014¹⁴. Veprimtaria e kësaj kompanie ka të bëjë me tregtinë e energjisë elektrike. Gjithashtu, në përputhje me Marrëveshjet e Energjisë të vitit 2013, u themelua kompania "ElektrodistribucijaSever" shpk. Zubin Potok më 19 nëntor 2014 si shoqëri për shërbime energjetike¹⁵. Ajo u themelua nga Kuvendi i Komunës së Zubin Potokut, që është në përputhje me Ligjin e Kosovës për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit komuna mund të jetë pronar ose bashkë-pronar i kompanisë. Qëllimi i themelimit të kësaj kompanie ishte dhënia e mundësisë qytetarëve të veriut të Kosovës që të lidhin kontratë me "ElektrodistribucijaSever-in" ose KEDS-in. Megjithatë, të dy kompanitë ende nuk janë regjistruar në Kosovë, e as nuk kanë marrë licencën për punë, ashtu si dhe shoqëria tregtare ELEKTROSEVER" në Mitrovicën Veriore, për krijimin e së cilës më 4 shtator 2015 edhe Qeveria e Serbisë ka dhënë miratimin e saj.

Aplikimet për regjistrimin e "EPS trgovina" dhe "ELEKTROSEVER" si degë të kompanisë Elektroekonomia e Serbisë dhe si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Kosovë, janë refuzuar për herë të parë në tetor të vitit 2015. Institucionet e Kosovës, si arsye për refuzim, kanë thënë se aplikimet nuk ishin në përputhje me ligjet e Kosovës dhe marrëveshjet e energjisë. Ndër të tjera, është thënë se në aplikacione është përdorur gjuhë "provokuese" si "Kosovë dhe Metohi", dhe se bëhet fjalë për shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e jo degë të kompanive. Kosova

13 Raporti për progresin e dialogut të Beogradit me Prishtinën për periudhën tetor 2015 – prill 2016 i Qeverisë së RS, 4. kapitulli – Energjia, i disponueshëm në: <http://www.kim.gov.rs/doc/pregovaracki-proces/1.1%20Izvestaj%20okt-mart%20%202016%20SR.pdf>

14 <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/13/ekonomija/2028114/eps-predao-zahteve-za-registraciju-firmi-na-kosovu.html>

15 http://kossev.info/strana/arhiva/_quotelektrodistribucija_sever__quot_doo_zubin_potok_osnovana_danas_u_ovojoj_opstini/2904

udhëzimet për revidim ia ka dërguar edhe Bashkimit Evropian si ndërmjetës në negociata, nga ku mëpastaj ka ardhur kërkesa për negociata për Kapitullin 35 dhe se duhet themeluar “Elektrosever-i” në përputhje me dispozitat në Kosovë.

Qeveria e Serbisë e ka refuzuar këtë kërkesë, sepse dokumenti me të cilin EPS-ja themelon ndonjë ndërmarrje sipas ligjeve të Kosovës nuk është kushtetues. Sipas marrëveshjeve ka qenë e paraparë që pronare e ndërmarrjes për furnizim të jetë Asociacioni i komunave serbe, por

It is true that we do not know what the next steps are. What all this entails; if the topic is energy, there would not be problems if we knew who is paying and to whom it is being paid

duke pasur parasysh se AKS nuk është themeluar ende, si pronar është emëruar Elektroekonomia e Serbisë. Aplikimet janë parashtruar dhe refuzuar edhe dy herë, dhe si arsye janë cekur mangësitë teknike.¹⁶ Aplikimi i datës 25 shkurt 2016 u refuzua për shkak të cekjes taksative të aktiviteteve pranë regjistrimit të shifrave konkrete të aktiviteteve, si dhe mpajtueshmërisë me legjislacionin e Kosovës.

Focus group Zubin Potok

Ngecjet më të mëdha në fazën e parë të negociatave për energji kishin të bënin me propozimin e Serbisë në lidhje me themelimin e kompanisë së re, e cila do ta zëvendësonte EPS-në, por do të mbante rolin e furnizuesit në veri të Kosovës dhe mjediset serbe. Kosova ka rënë dakord për të krijuar një kompani të re, por roli i saj do të reduktohej në mbledhjen e pagesës nëpërmjet llogarive të tyre, ndërsa roli i furnizuesit i mbetet KEK-ut, dhe roli i shpërndarësit KEDS-it. Në atë kohë u theksua se kompanive tjera të furnizimit me energji elektrike do tu mundësohej të fillonin të veprojnë në Kosovë pas hapjes së tregut të përgjithshëm të energjisë në janar 2015. Kjo do të thoshte që kompanitë e reja serbe në fushën e energjisë nuk do të kufizoheshin vetëm në veri të Kosovës, por të gjithë banorët e Kosovës do të ishin në gjendje të jenë shfrytëzues të shërbimeve të tyre.

Duke qenë se ‘ElektrodistribucijaSever’ ende nuk është regjistruar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve e Kosovës (ARBK), në Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës e as nuk i është dhënë licenca nga Zyra e Rregullatorit të Kosovës (ZRRE), kjo kompani nuk lëshon fatura në veri të Kosovës.

Të dhënat e fundit zyrtare në lidhje me rrjedhën e zbatimit të marrëveshjes për energjinë janë në dispozicion në raportin e Zyrës për Kosovë dhe Metohi dhe

¹⁶ Raporti i progresit të dialogut Beograd Prishtinë për përiudhën tetor 2015 – prill 2016 i Qeverisë së RS, 4. kapitulli - Energjia

tregojnë për një refuzim të ri të aplikimeve për regjistrimin të kompanive të dorëzuara me 26 prill 2017, përsëri për shkak të dokumentacionit që është “jo i plotë dhe jo në përputhje me ligjet e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit”.

Duke shpjeguar pretendimet e refuzimit si të paqarta, pala serbe ka paraqitur një kërkesë në ABRK për të rishqyrtuar vendimin për refuzimin e kërkesës për regjistrimin e kompanive energjetike. Për shkak se në kërkesën lëndore nuk është dhënë përgjigje brenda afatit të caktuar, pala serbe kundër aktit për refuzim të kërkesës për regjistrim ka paraqitur një ankesë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe padi në Gjykatën Administrative në Prishtinë. Pas më shumë se 4 muaj nga paraqitja e padisë/ankesës, më 19 tetor 2017, Gjykatës në Prishtinë i është dorëzuar një kërkesë urgjente me të cilën kërkohet njoftim me shkrim në lidhje me statusin e procedurës.¹⁷

Për shkak të kësaj, marrëveshjet në mes të KOSTT dhe EMS në kuadër të organizimit të Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E), e ashtuquajtura Marrëveshja e lidhjes (CA) ende nuk ka hyrë në fuqi.

Negociatorët serbë besojnë se ndërmjetësit e BE duhet të marrin masat e nevojshme për të gjetur një zgjidhje për regjistrimin e kompanive dhe dhënien e licencave të nevojshme për punën e tyre.

17 Zyra për KeM, Raporti për progresin në dialogun e Beogradit dhe Prishtinës, tetor 2016 – prill 2017: <http://www.kim.gov.rs/doc/lzvestaj%20oktobar%20april%202017%20pdf.pdf>

PĚRFUNDIM

4

TELEKOMUNIKIMET

Telekomunikacioni është një nga pikat kryesore të marrëveshjes së Brukselit. Pala serbe dhe ajo e Kosovës kanë marrë përsipër obligimin për të intensifikuar diskutimet në këtë fushë, gjë që mund të shihet edhe në terren, sepse zbatimi marrëveshjes është në vazhdim e sipër. Megjithatë, qytetarët nuk ishin të informuar me kohë për atë se çfarë nënkupton marrëveshja në këtë fushë. Kështu vazhdoi edhe në vijim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Qytetarët në fokus grupe theksuan se në këtë proces nuk kishte fushatë informimi, duke shprehur shqetësim lidhur me proceset e ardhshme. Ajo që më së shumti i brengos konsumatorët e kompanisë MTS shpk është mundësia që, në një moment, të fillojë ngarkesa e tarifave për thirrjet me Serbinë si me ndonjë shtet tjetër, gjë që do të rriste ndjeshëm shpenzimet për shërbimet e telefonisë.

Duhet thënë se ka shumë pak të dhëna të disponueshme për negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në fushën e telekomunikimeve. Dialogjet janë mbajtur në Bruksel dhe mediave u janë lëshuar komunikata vetëm pas takimeve disaditëshe. Rrjedha e vetë bisedimeve nuk është përcjellur. Informatat për publikun kanë ardhur kryesisht përmes deklaratave të zyrtarëve të të dy palëve lidhur me marrëveshjet e arritura, të cilat shpesh ishin kontradiktore. Raportet e Qeverisë së Serbisë, përkatësisht të Zyrës për Kosovë dhe Metohi dhe Zyrës për koordinim të punëve në procesin e negociatave me institucionet e Prishtinës në këto fusha janë shumë të vakëta. Raporti i Komisioni Evropian për përparimin e Serbisë në negociatat me BE-në për Kapitullin 35 – normalizimi i marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, nuk merret me aktivitetet e sakta që të dyja palët janë duke ndërmarrë në fushën e energjisë dhe telekomunikimeve, por jep vetëm vlerësime të përgjithshme. Kjo shkon në favor të përfundimeve të hulumtimeve të mëparshme, të cilat flasin për mungesë të transparencës në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit.

Afatet kohore që janë vendosur nuk respektohen në masë të madhe. Nuk ka pasur as prioritete në negociata. Disa çështjeve thelbësore, të tilla si pronësia mbi pasurinë, u ka ardhur radha vetëm pas hapjes së çështjeve shumë më pak të rëndësishme. Raportimi i mediave në fushën e negociatave në përgjithësi nuk kontribuon në sqarimin e procedurave komplekse dhe se çfarë domethënie kanë ato vërtetë për qytetarët. Fokusi është vënë është në aspektet teknike të marrëveshjes, ose më mirë në listën faktike të pikave të marrëveshjes, pa një material kërkimi më të thellë.

Ankesat e qytetarëve të Kosovës, për cilësinë e jetës së të cilëve bëhet fjalë, flasin për plogështinë dhe ngathtësinë e procesit në tërësi. Problemet më banale, si liria e komunikimit, mbeten të hapura. Është fakt se në këto fusha të negociatave është evidente mungesa e mendimit të atyre që jetojnë në territorin e Kosovës, gjë që çon në përfundim se procesi është pa pjesëmarrje dhe në këtë mënyrë jolegjitim. Interesat e qytetarëve janë vetëm në vendin e dytë, pas interesave të larta politike.

ENERGJIA

Zbatimi i marrëveshjes së energjisë, në krahasim me telekomunikimet, mund të ballafaqohet me sfida shumë më të mëdha për shkak të vetë kompleksitetit të fushës. Tani për tani, parakushtet për realizimin e saj ende nuk janë përmbushur. Kjo përfshin rindërtimin e rrjetit të energjisë, i cili është vjetruar dhe rregullimin e gjendjes së kyçjeve të paligjshme në rrjet, duke pasur parasysh se 19 vitet e fundit (nga viti 1999 deri në 2018) nuk ka pasur kontroll në këtë fushë. Një nga sfidat më të mëdha do të jetë mbledhja e pagesës për konsumin e energjisë elektrike nga konsumatorët në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit të cilët në përgjithësi nuk paguajnë. Nga ana tjetër, autoritetet e Kosovës pretendojnë borxhe për shkak të humbjeve në sistemin energjetik në Kosovën e veriut, për shkak të mos pagesës së faturave në katër komuna. Edhe pse amvisëritë marrin faturat për energjinë e shpenzuar nga ndërmarrja Elektrokosmet, vetë qytetarët dyshojnë për kompetencat e kësaj kompanie. Kjo është në një farë mase e arsyeshme nëse marrim parasysh se Elektroekonomia e Serbisë distancohet nga juridiksioni në territorin e Kosovës, kur është fjala për sistemin energjetik. Çështja e pronës është një nga pikat e diskutueshme midis negociatorëve nga Beogradi dhe Prishtina, për shkak se edhe gjatë negociatave për temën e energjisë kjo çështje është lënë mënjanë. Mungesa e transparencës për vetë marrëveshjen dhe mungesa e debatit publik mes e palëve kryesore të interesuara, si dhe mungesa e informimit të qytetarëve, ekspertëve, shoqërisë civile dhe komunitetit akademik shton konfuzionin rreth perspektivave në sektorin e energjisë. Punonjësit e në njësitë punuese të Elektrokosmetit në veri të Kosovës nuk pranojnë të diskutojnë këtë temë me hulumtuesit dhe mediat, që mbyll hapësirën që problemet e tyre në procesin e afarizmit dhe marrëveshjes së Brukselit të bëhen publike. Ekzistojnë shumë pak informata të disponueshme për fushën e energjisë, dhe interpretime të ndryshme të marrëveshjeve të njëjta mund të dëgjohen nga negociatorët nga Beogradi dhe Prishtina. Nga të gjitha këto që u thanë më lartë, mund të konkludohet se parakushtet themelore për zbatimin e marrëveshjes së energjisë ende nuk janë plotësuar. Kemi të bëjmë edhe me një marrëveshje tjetër politike që nuk ka bazë të qartë në praktikë. Do duhej të nxirren mësim nga përvojat dhe gabimet gjatë zbatimit të marrëveshjes së telekomunikacionit në mënyrë që ato të mos përsëriten në periudhën e ardhshme. Duke marrë parasysh kompleksitetin e fushës së energjisë krahasuar me telekomunikacionin, gabime të ngjashme nuk duhet të përsëriten sepse ato do të prodhonin probleme shumë më të mëdha në zbatim se sa ka qenë rasti deri më tani.

REKOMANDIME



REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- Zhvillimi i fushatave informuese për zbatimin e marrëveshjes për energjinë dhe telekomunikacionin;
- Përfaqësuesit e kompanive të telekomunikacionit dhe të furnizimit me energji elektrike duhet që krahas me faturat të japin njoftimet për ndryshimet në kushtet e punës, me një shpjegim të hollësishëm të këtyre ndryshimeve sa i përket qytetarëve;
- Është e nevojshme të punohet më intensivisht në arritjen e një zgjidhjeje për çështjen e pronës në kuadër të negociatave të Brukselit,
- Përcaktimi i të drejtave të punëtorëve të Elektroekonomisë së Serbisë dhe kushtet e kalimit në kompanitë EPS trgovina dhe Elektroserver.

TELEKOMUNIKMET

- Realizimi i vazhdimësisë në cilësinë dhe çmimet e shërbimeve të operatorit të telekomunikacionit MTS shpk pas skadimit të periudhës së licencimit, duke ruajtur të drejtën e komunikimit brenda rrjetit MTS të barabartë me shfrytëzuesit e shërbimeve në Serbi;

ENERGJIA

- Rregullimi i problemeve të infrastrukturës në rrjetin elektrik (zëvendësimi i matësve të vjetër me të ri, vendosja e njehsorëve në familjet që nuk i kanë ata, përkatësisht legalizimi i kyçjeve të paligjshme);
- Përgatitja e publikut të gjerë për vendosjen e mbledhjes së pagesave për energjinë elektrike të furnizuar në veri të Kosovës duke përdorur kanalet e komunikimit në dispozicion;
- Me rastin e vendosjes së mbledhjes së pagesave për energji elektrike në veri të Kosovës të fshihen borxhet e deritashme dhe të fillohet nga pika “zero” për mbledhjen e pagesës.

REKOMANDIME PËR QYTETARËT

- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet publike në fushën e marrëveshjeve të energjisë dhe telekomunikacionit;
- Është e domosdoshme rritja e interesimit dhe aktivizimi qytetar kur është në pyetje mbikëqyrja e zbatimit të këtyre marrëveshjeve;
- Qytetarët duhet të përdorin më shumë kanalet e disponueshme të komunikimit me vendimmarrësit;
- Rritja e nivelit të komunikimit të qytetarëve me mediat dhe sektorin joqeveritar i cili mund të artikulojë më mirë qëndrimet e tyre dhe t'i bëjë ato të disponueshme për publikun.

LITERATURA

1. Teksti i Marrëveshjes së Brukselit i disponueshëm në: <http://www.kim.gov.rs/p03.php>
2. Themelimi i MTS shpk në ARBK - <http://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=3,38,38A0000051>
3. Konkluzionet e ndërmjetësve të BE në lidhje me telekomunikimet të datës 13 nëntor 2016, pika 11: <http://www.kim.gov.rs/p23.php>
4. Raporti i progresit në dialogun e Beogradit dhe Prishtinës për periudhën tetor 2015 – prill 2016 i qeverisë së RS, 5. kapitulli – Telekomunikimet: <http://www.kim.gov.rs/p05.php>
5. Marrëveshja e nëntorit 2016, Konkluzionet e ndërmjetësve të BE në lidhje me telekomunikimet, të disponueshme në: <http://www.kim.gov.rs/p23.php>
6. Marrëveshja për telekomunikime e vitit 2013, pika 6: në dispozicion në: <http://www.kim.gov.rs/lat/pregovaracki-proces.php>
7. Plani i veprimit për zbatimin e Marrëveshjes për telekomunikime është në dispozicion në: <http://www.kim.gov.rs/doc/pregovaracki-proces/Azurirani%20akcioni%20plan%20u%20oblasti%20telekomunikacija.pdf>
8. Raporti për Zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit, zyra për hulumtime sociale, viti 2014, në dispozicion në: <http://www.birodi.rs/wp-content/uploads/2015/02/BIRODI-Izvestaj-o-implementaciji-BS.pdf>
9. Raporti për progresin prj tetorit 2017, Zyra për Kosovës, e disponueshme në <http://www.kim.gov.rs/pregovaracki-proces.php>
10. Shqyrtimi i zbatimit të dialogut Kosovë-Serbi, Programi për ndërtimin e paqes dhe për të drejtat në Institutin e Unverzitetit të Kolumbias për studimin e të drejtave të të drejtave njerëzore: http://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017_09_05_kosovo-serbia_report.pdf
11. Letra e Edita Tahirit për Bashkimin Evropian/Drejtorin të Shërbimit Evropian për Aktivitete të Jashtme, Angelina Eichhorst: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REPORT_-Brussels_Agreements_Pending_Implementation_060717.pdf
12. Ta pyesim veriun, qëndrimet e qytetarëve për shërbimet publike dhe komunale: <http://crnobelismet.com/wp-content/uploads/2017/07/PITAJMO-SEVER.pdf>
13. ITU Buletini Operativ 01.05.2017: https://www.itu.int/dms_pub/itu-t/opb/sp/T-SP-OB.1123-2017-OAS-PDF-E.pdf
14. Mposhtja e pengesave për afarizëm dhe normalizimi. Forumi për raporte etnike: https://rs.boell.org/sites/default/files/prevladavanje_barijera_zaposlovanje_i_normalizacija.pdf

Ky dokument u zhvillua në kuadër të projektit "A mund të shohim dhe a si e dëgjojmë vetën pas Marrëveshjes së Brukselit" – Analizë e Marrëveshjes së Brukselit për telekomunikacion dhe energjetikë, të cilin e implementon OJQ "Radio Mir", ndërsa e mbështet Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Qëndrimet e paraqitura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimet e KFOS-it.

